



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**

V E N D I M

**PËR REGJISTRIMIN E KOALICIONIT "ALEANCA PËR SHQIPËRINË EUROPIANE",
(ASE) PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE
TË DATËS 30 QERSHOR 2019**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në mbledhjen e datës 07.05.2019, me pjesëmarrjen e:

Klement	ZGURI -	Kryetar
Denar	BIBA -	Zv.Kryetar
Bledar	SKËNDERI-	Anëtar
Edlira	JORGAQI-	Anëtare
Rezarta	BITRI-	Anëtare

Shqyrtoi çështjen me

OBJEKT: Për regjistrimin e Koalicionit "Aleanca për Shqipërinë Europiane" (ASE), për zgjedhjet për Organet e Qeverisjes Vendore, të datës 30 Qershor 2019.

Baza Ligjore: Neni 23, pika 1, germa "a", neni 65 i Ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar dhe vendimi i KQZ-së Nr. 32, datë 06.03.2015 "Për miratimin e disa rregullave për regjistrimin e Koalicioneve Zgjedhore në KQZ".

KQZ pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur si dhe dëgjoi diskutimet e përfaqësuesve të partive politike,

VËREN

Presidenti i Republikës, në mbështetje të nenit 92, shkronja "gj", dhe nenin 93 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe të nenit 9, paragrafi 1, të ligjit nr. 10019 , datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar, me Dekretin nr.10928, datë 05.11.2018 ka caktuar datën 30 Qershor 2019, për zhvillimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore.

Në mbështetje të nenit 64 të Kodit Zgjedhor, Partia Socialiste e Shqipërisë me Kryetar Z. Edi Rama, Partia Socialdemokrate e Shqipërisë me Kryetar z. Skënder Gjinushi, Partia Demokracia Sociale me Kryetar z. Paskal Milo, Partia Aleanca Demokratike Shqiptare me Kryetar z. Eduard Abazi, Partia Aleanca Arbnore Kombëtare me Kryetar z. Gjet Ndoji, Partia Aleanca për Barazi dhe Drejtësi Europiane me Kryetar z. Valentino Mustaka, Partia G99 me Kryetar



Nr. 251 i Vendimit Data 07.05.2019 e Vendimit Ora 11:00 e Vendimit

Për regjistrimin e Koalicionit "Aleanca për Shqipërinë Europiane" (ASE), për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 Qershor 2019

z. Redi Shtino, Partia Aleanca për Demokraci dhe Solidaritet me Kryetar z. Gaqo Apostoli, Partia Ardhmëria Shqiptare me Kryetar z. Emin Subashi, Partia Demokrate për Integrim dhe Prosperitet me Kryetar z. Kujtim Muça, Partia e Gjellbër me Kryetar z. Edlir Petanaj, Partia e Pajtimit Kombëtar Shqiptar me Kryetar z. Spartak Dobi, Partia Kristian Demokrate me Kryetar z. Dhimtër Muslia, Partia e Reformave Demokratike Shqiptare me Kryetar z. Krenar Rryçi, Partia e të Drejtave të Mohuara me Kryetar z. Ilir Vata, Partia Unitetit Kombëtar me Kryetar z. Idajet Beqiri, Partia Lëvizja Punëtore Shqiptare me Kryetar z. Genci Sakaj, Partia për Mbrojtjen e të Drejtave të Emigrantëve me Kryetar z. Ymer Kurti, Partia Socialiste e Moderuar me Kryetar Gjergji Koja, Partia Socialpunëtore Shqiptare me Kryetar z. Ramadan Ndreka, Partia Aleanca Demokristiane e Shqipërisë me Kryetar z. Zef Bushati, janë regjistruar pranë KQZ-së, si subjekte zgjedhore për Zgjedhjet e Organeve të Qeverisjes Vendore të 30 Qershorit 2019.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka bërë respektivisht regjistrimin e këtyre partive si subjekte zgjedhore me vendimet, nr.148, datë 11.04.2019, nr.139 datë 09.04.2019, nr.197, datë 23.04.2019, nr.228, datë 27.04.2019, nr.229, datë 27.04.2019, nr.108, datë 27.03.2019, nr.227, datë 27.04.2019, nr.149, datë 11.04.2019, nr.110, datë 27.03.2019, nr.107, datë 27.03.2019, nr.28, datë 22.02.2019, nr.199, datë 23.04.2019, nr.32, datë 04.03.2019, nr.196, datë 23.04.2019, nr.69, datë 20.03.2019, nr.37, datë 11.03.2019, nr.67, datë 20.03.2019, nr.169, datë 16.04.2019, nr.38 datë 11.03.2019, nr.200, datë 23.04.2019, nr.31, datë 04.03.2019.

Me shkresën nr.2632 prot., datë 02.05.2019, në Zyrën e Protokollit të KQZ-së, partitë e sipërpërmendura, nëpërmjet kërkesës së bërë nga z. Edi Rama kërkojnë regjistrimin e koalicionit "Aleanca për Shqipërinë Europiane" (ASE) si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019.

Bashkëlidhur kërkesës për regjistrimin e koalicionit "Aleanca për Shqipërinë Europiane", (ASE) është depozituar edhe marrëveshja për krijimin e koalicionit, në të cilën është shprehur vullneti i partive të sipërpërmendura për të qenë pjesëmarrëse të këtij koalicioni. Në kërkesë është pasqyruar emri i koalicionit "Aleanca për Shqipërinë Europiane", shkronjat nistore, mënyra e paraqitjes së kërkesave të koalicionit për regjistrimin e kandidatëve sipas përcaktimeve të bëra në Kod dhe aktet e KQZ-së, emri e mbiemri i personit i cili do të ketë të drejtën të caktojë vëzhgues në KZAZ, KQV dhe VNV.

Në marrëveshje është përcaktuar se z. Eridjan Saliç autorizohet për të përfaqësuar koalicionin gjatë procedurës së shortit në KQZ për renditjen e subjekteve zgjedhore në fletën e votimit. Gjithashtu marrëveshja ka autorizuar z. Edi Rama, Kryetarin e Partisë Socialiste të paraqes kërkesën në KQZ, për regjistrimin e koalicionit.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, bëri verifikimet përkatëse dhe konstatoi se, dokumentacioni i paraqitur nga 21 partitë e sipërcituara është në përputhje me nenin 65, të ligjit Nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar dhe Vendimin e KQZ nr.32, datë 06.03.2015 "Për miratimin e disa rregullave për regjistrimin e koalicioneve zgjedhore në KQZ.



Nr. 251 i Vendimit Data 07.05.2019 e Vendimit Ora 11:00 e Vendimit

Për regjistrimin e Koalicionit "Aleanca për Shqipërinë Europiane" (ASE), për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 Qershor 2019

VENDOSI:

1. Të regjistrojë Koalicionin "Aleanca për Shqipërinë Europiane", (ASE) si subjekt zgjedhor pjesëmarrës në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019, me parti pjesëtare të tij si më poshtë:

- 1- Partia Socialiste e Shqipërisë;
- 2- Partia Socialdemokrate e Shqipërisë;
- 3- Partia Demokracia Sociale;
- 4- Partia Aleanca Demokratike Shqiptare;
- 5- Partia Aleanca Arbnore Kombëtare;
- 6- Partia Aleanca për Barazi e Drejtësi Europiane;
- 7- Partia G 99;
- 8- Partia Aleanca për Demokraci dhe Solidaritet;
- 9- Partia Ardhmëria Shqiptare;
- 10-Partia Demokrate për Integrim dhe Prosperitet;
- 11-Partia e Gjellbër;
- 12-Partia Pajtimit Kombëtar Shqiptar;
- 13-Partia Kristian Demokrate;
- 14-Partia Reformave Demokratike Shqiptare;
- 15-Partia e të Drejtave të Mohuara;
- 16-Partia Unitetit Kombëtar;
- 17-Partia Lëvizja Punëtore Shqiptare;
- 18-Partia për Mbrojtjen e të Drejtave të Emigrantëve;
- 19-Partia Socialiste e Moderuar;
- 20-Partia Socialpunëtore Shqiptare;
- 21-Partia Aleanca Demokristiane e Shqipërisë.

2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda 5 ditëve nga shpallja e tij.

Klement	ZGURI -	Kryetar
Denar	BIBA -	Zv.Kryetar
Bledar	SKËNDERI-	Anëtar
Edlira	JORGAQI-	Anëtare
Rezarta	BITRI-	Anëtare



Nr. 251 i Vendimit Data 07.05.2019 e Vendimit Ora 11:00 e Vendimit

Për regjistrimin e Koalicionit "Aleanca për Shqipërinë Europiane" (ASE), për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 Qershor 2019